

VENDIM
Nr. 997, datë 10.12.2010

PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË PUNONJËSVE QË DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË
QENDRËS SË PUNËS, BRENDA VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- I. Punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilët gjatë ditëve zyrtare të punës shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit.
- II. Në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në kuptim të këtij vendimi, përfshihen:
 1. njësitë e qeverisjes qendrore, që janë: njësitë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë, me ligj ose me vendim të Këshillit të Ministrave;
 2. njësitë e qeverisjes vendore, që janë njësitë e niveleve të ndryshme vendore, të krijuara me ligj;
 3. njësitë e fondeve speciale, që janë njësitë e krijuara me ligje specifike.
- III. Trajtimi financiar i punonjësve për përballimin e shpenzimeve të shërbimit, bëhet i diferencuar, sipas distancës së shërbimit nga qendra e punës, si më poshtë vijon:
 1. Për shërbime në një largësi deri në 100 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifa përkatëse sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.307, datë 20.7.1992 të Këshillit të Ministrave "Për tarifën e transportit të udhëtarëve", të ndryshuar.
 2. Përfshihen nga pika III-1, punonjësit e Policisë së Shtetit, punonjësit e Gardës së Republikës dhe punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, kur marrin pjesë në shërbime operacionale. Në këto raste, këta punonjës trajtohen sipas pikës III-3 të këtij vendimi.
 3. Për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës, punonjësit i përballohen shpenzimet e mëposhtme:
 - a) Dietë ditore, e cila për çdo punonjës të dërguar me shërbim, llogaritet:
 - i) në masën 1000 (një mijë) lekë në ditë, kur punonjësi kthehet brenda ditës;
 - ii) në masën 10 për qind të pagës mujore, por jo më shumë se 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë, kur shërbimi zgjat më shumë se një ditë. Për efekt të llogaritjes së dietës, në këtë rast, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë.
 - b) Shpenzimet e fjetjes kundrejt dokumentit tatimor përkatës të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale, por jo më shumë se 3000 (tre mijë) lekë, për çdo natë.
 - c) Shpenzimet e transportit në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.307, datë 20.7.1992 të Këshillit të

Ministrave "Për tarifat e transportit të udhëtarëve", të ndryshuar.

IV. Dokument tatimor, për efekt të këtij vendimi, do të konsiderohet çdo biletë transporti e miratuar nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe çdo faturë e thjeshtë apo me TVSH, e cila detyrimisht duhet të shoqërohet me faturë të printuar nga kasa elektronike fiskale.

V. Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga:

1. Titullari i njësisë shpenzuese për shërbimet me largësi deri në 100 km jashtë qendrës së punës.

2. Titullari i institucionit qendror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës. Në autorizim përcaktohen koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij. Titullarë institucioni qendror, në kuptim të këtij vendimi, janë:

a) Për njësitë e qeverisjes qendrore:

i) për ministrinë dhe çdo institucion në varësi të saj, ministri ose i deleguari i tij;

ii) për aparatet e Presidencës, të Kuvendit, të Këshillit të Ministrave, të enteve kushtetuese, si dhe për institucionet në varësi të Kryeministrit, sekretari i përgjithshëm përkatës;

iii) për punonjësit e gjykatës, kryetari i gjykatës.

b) Për njësitë e qeverisjes vendore, kryetari njësisë vendore.

c) Për fondet speciale, titullari i fondit special.

VI. Prefektët e qarqeve që kryejnë funksione larg vendbanimeve të tyre, kur nuk u janë siguruar kushtet për fjetje pranë vendit të punës, përfitojnë dietë dhe u paguhen shpenzimet e ditës sipas pikës III- 3 të këtij vendimi për një periudhë jo më shumë se një muaj. Pas një muaji nga data e emërimit të tij, shpenzimet e fjetjes, por jo më shumë se 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj përballohen nga vetë institucioni urdhërues, deri në momentin e sigurimit të një banese.

VII. Studentët dhe nxënësit, si dhe trupa shoqëruese pedagogjike, që kryejnë praktika mësimore, ekspozita apo veprimtari jashtë qendrës së institucionit arsimor publik, nuk përfitojnë dietë. Shpenzimet e udhëtimit dhe të fjetjes së tyre përballohen nga institucionet përkatëse të arsimit, sipas dokumenteve përkatëse tatimore, të përcaktuara në pikën IV të këtij vendimi.

VIII. Vendimi Nr.228, datë 13.4.2001 i Këshillit të Ministrave "Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre", të ndryshuar, si dhe çdo vendim apo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM

Nr.307 Date 20.7.1992

PER

NDRYSHIMIN E TARIFAVE TE TRANSPORTIT TE UDHETAREVE

Me propozimin e Ministrise se Financave dhe te Ekonomise dhe te Ministrise se Transporteve dhe te Komunikacioneve, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Tarifat e transportit qytetar te udhetareve ne linjat me largesi deri ne 9 km, por brenda periferise se qytetit caktohen 1,5 leke per vajtje ose kthim, 50 leke per nje bilete pajtimi mujore dhe 140 leke per ate tremujore. Per nxenesit dhe studentet bileta e pajtimit mujor caktohet 25 leke dhe e pajtimit tremujor 70 leke.
2. Tarifat e transportit nderqytetar ne transportin shteteror te udhetareve automobilistik, uxor (detar e liqenor) dhe ne ate hekurudhor rriten mesatarisht 4 here kundrejt atyre ekzistuese.
3. Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, se bashku me Ministrine e Financave e te Ekonomise mbi bazen e rritjes se tarifave te percasktuara ne piken 2 te ketij vendimi, percakton cmimet e biletave sipas linjave ne transportin shteteror automobilistik e uxor, ne transportin hekurudhor sipas zonave dhe cmimet e bioletave te pajtimit ne transportin e punonjesve jashte periferise se qytetit.
Per transportin privat nderqytetar automobilistik dhe uxor te udhetareve, zbatohen cmimet e biletave te miratuara per transportin shteteror".
Çmimet e biletave mund te ndryshohen mbi bazen e kerkesave qe paraqesin subjektet, per efekt te rritjes se shpenzimeve, si rezultat i liberalizimit dhe i rritjes se cmimeve.
4. Çmimet biletave te linjave nderkombetare ne transportin automobilistik, detar e uxor miratohen nga Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, ne bashkepunim me organin kompetent te shtetit te huaj, ne castin e lidhjes se marreveshjes ose te dhenies se licences.
5. Persopnat juridike e fizike dhe drejtuesit e mjeteve jane te detyruar t'i pajisin udhetaret me bileta udhetime, te cilat pergtien dhe shperndahen ne menyre te perqendruar nga organi I autorizuar nga Ministria Transporteve dhe e Komunikacioneve.
6. Ministria e Financave dhe e Ekonomise dhe Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, kur tarifat e transportit te udhetareve jane me te uleta se shpenzimet i propozojne Keshillit te Minsitrave miratimin emases se subvencionit.
Diferenca ndermjet cmimit te biletave te pajtimit dhe shpenzimeve faktike per tyransoportin e punonjesve jashte periferise se qytetit, por brenda rrethit, perballohet nga vete ndermarrjet dhe institucionet.

7. Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, se bashku me Ministrine e Financave dhe te Ekonomise nxjerr udhezimet ne zbatim te ketij vendimi.
8. Cdo dispozite qe bie ne kundersiztim me kete vendim, shfuqizohet.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
ALEKSANDER MEKSI

